



## Shqyrtimi i Tretë Tarifor i Energjisë Elektrike 2009 - Raporti Konsultativ, shtesa për KOSTT

5 mars 2009

### DEKLARATË

Ky raport konsultativ është përgatitur nga ZRrE për të pranuar komente nga palët e interesuara. Nuk është dokument vendimtar dhe nuk duhet të konsiderohet si dokument që paraqet vendim të ZRrE-së.

## 1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji është në procesin e shqyrtimit të tretë tarifor të tarifave të energjisë elektrike që do të aplikohen nga KEK sh.a. dhe të tarifave të transmisionit që do të aplikohen nga KOSTT sh.a. nga data 1 prill 2009. ZRrE ka pranuar aplikacionin final për tarifa nga KEK-u dhe KOSTT-i më 18 shkurt 2009. Ky dokument është shtesë e Raportit Konsultativ të publikuar nga ZRrE më datën 3 mars 2009, që përmbante propozimet fillestare të ZRrE-së për të ardhurat e lejuara dhe tarifat me pakicë. Ky dokument përshkruan ndikimet e Raportit Konsultativ në tarifat e KOSTT-it. Komentet eventuale duhet të dërgohen përmes postës elektronike në adresën [ero.pricing-tariffs@ero-ks.org](mailto:ero.pricing-tariffs@ero-ks.org), me titull "Komente për SHTE<sub>3</sub>". Komentet e shtypura "hard-copy" mund të dërgohen në adresën "Rr. Hamdi Mramori Nr 1, 10000 Prishtinë" me mbishkrimin "Departamenti për Tarifa dhe Çmime".

## 2 Të ardhurat e lejuara për KOSTT

### 2.1 Të ardhurat e lejuara me përjashtim të humbjeve të lejuara të transmisionit

Siç është deklaruar në Raportin Konsultativ, ZRrE propozon që KOSTT-it t'i lejohet të mbulojë kosto të lejuara prej 11.8 milion euro, duke mos përfshirë këtu humbjet e transmisionit në vitin 2009

### 2.2 Qëllimi i lejimit të humbjeve të transmisionit

KOSTT-i detyrohet që humbjet e realizuara gjatë shërbimit të konsumatorëve në Kosovë t'i blejë nga divizioni i furnizimit të KEK-ut. KOSTT-i ka mundësi të mbulojë një sasi të arsyeshme të këtyre kostove. Ky nivel vendoset nga ZRrE, si pjesë e të ardhurave të lejuara të KOSTT-it.

Kostoja e këtyre humbjeve nuk është përfshirë në të ardhurat e lejuara të KOSTT-it të propozuara në Raportin Konsultativ. Sidoqoftë, kjo kosto duhet t'i shtohet të ardhurave të lejuara që duhet të mbulohen nga tarifat e KOSTT-it kur merret vendimi për këto tarifa. Në anën tjetër, të ardhura të lejuara të të njëjtës vlerë i lejohen divizionit të furnizimit, së bashku me një rritje në të ardhurat e parregulluara (në mënyrë që efekti i përgjithshëm në kostot e divizionit të furnizimit në tarifat me pakicë të jetë zero).

### 2.3 Propozimi për humbjet e lejuara të vitit 2009

Përkundër kërkesës së KOSTT-it që faktori i lejuar i humbjeve të transmisionit (TLF) për vitin 2009 të rritet, ZRrE ka propozuar që faktori i vitit 2008 (1.041) të mbetet i njëjtë edhe për vitin 2009. Bazuar në informatat e dorëzuara nga KEK, ZRrE pret që vëllimi I përgjithshëm i energjisë (definuar si: Importi + gjenerimi i kyçur në transmision – eksporti) që do të bartet nga KOSTT-i do të jetë 5,059 GWh. Kjo paraqet humbje të pritura të rrjetit të transmisionit prej 199 GWh në vitin 2009.

Kostoja e blerjes së këtyre humbjeve është vendosur si kostoja mesatare e blerjes së energjisë në nivelin e transmisionit, që është mesatarja e shumës të të ardhurave të lejuara të divizioneve të Gjenerimit dhe Minierave të KEK-ut, dhe kostove të lejuara për blerjen e energjisë nga gjeneratorët tjerë (që nuk janë të KEK-ut) dhe nga importet. Kjo shumë pjesëtohet me blerjet totale të energjisë për të mbuluar kërkesën në Kosovë, duke dhënë 31.3 €/MWh, siç është paraqitur në Raportin Konsultativ. Nga kjo rrjedh se humbjet totale të lejuara për KOSTT-in janë 6.2 milion euro.

Të ardhurat e lejuara totale për KOSTT –in të propozuara nga ZRrE-ja kur përfshihen humbjet janë përafërsisht 18 milion euro.

**Tabela 1: Përshkrim i të ardhurave të lejuara**

		2009 Propozuar
Të ardhurat e lejuara duke mos përfshirë shërbimet ndihmëse dhe humbjet në transmision	€000	10,237
Të ardhurat e lejuara për blerjen e shërbimeve ndihmëse	€000	1,591
<b>Të ardhurat e lejuara pa humbjet në transmision</b>	€000	<b>11,828</b>
Të ardhurat e lejuara për blerjen e humbjeve në transmision	€000	6,228
<b>Të ardhurat e lejuara - TOTALI</b>	€000	<b>18,056</b>

## 3 Tarifat e propozuara të Transmisionit

KOSTT-it i lejohej të aplikojë tri lloje të tarifave (ngarkesave) të transmisionit:

- Tarifa për shfrytëzimin e sistemit të transmisionit (SHST) që vendoset për mbulimin e kostove të KOSTT-it si pronar i rrjetit të transmisionit (TNO). Në këto kosto përfshihen shpenzimet e investimit në rrjet dhe mirëmbajtjes së rrjetit.
- Tarifa për operatorin e sistemit (OS). Kjo tarifë mbulon kostot e KOSTT-it si operator sistemi, dhe përfshijnë kostot e blerjes së shërbimeve ndihmëse së bashku me kostot e blerjes së humbjeve të transmisionit.
- Tarifa për Operatorin e Tregut (OT). Kjo tarifë mbulon kostot direkte të KOSTT-it si operator i tregut me shumicë në Kosovë.

Në aplikacionin e tyre, KEK ka sugjeruar disa ndryshime të vogla për ndarjen e kostove në mes të SHST dhe OS. Këto kosto ndryshojnë nga kostot e aplikuara në vitin 2008, siç shihet në Tabelën 2, që do të thotë ndryshime në tarifat relative. Këto kosto nuk janë sqaruar në aplikacion. ZRrE synon t'i shqyrtojë këto ndryshime me KOSTT-in para se të marrë një vendim përfundimtar mbi to.

**Tabela 2: Ndarja e kostove në tarifa**

	2008	2009
	Lejuar	Propozuar
Kostot e TNO (mbulohen nga ngarkesat e SHST)		
400/220kV	40.3%	43.1%
110kV	42.8%	42.3%
Kostot direkte te OS (nuk përfshihen kostot e humbjeve dhe shërbimeve ndihmëse)	15.6%	12.9%
Kostot e OT	1.3%	1.8%

*Kostot e humbjeve dhe shërbimeve ndihmëse janë alokuar tek kostot e OS*

ZRrE pret të ketë zbritje të tarifave për fuqinë e angazhuar në nivelin 400/220kV, për shkak të zvogëlimit të kërkesës nga Ferronikeli. ZRrE nuk pajtohet se ky ndryshim i përkohshëm do të rezultojë në ngritje të mëdha të tarifave të SHST në këtë nivel tensioni (kjo do të ndëshkonte pa ndonjë arsye konsumatorët e kyçur në këtë nivel)<sup>1</sup>. ZRrE propozon që tarifat SHST në të dy nivelet e tensionit të ngritën me të njëjtin nivel. Kjo është aplikuar në llogaritjen e tarifave të propozuara në vijim. Fuqia e angazhuar për tarifat e OS dhe OT kalkulohet si shuma në mes të energjisë që hyn në rrjetin e transmisionit nga gjeneratorët në Kosovë dhe energjisë që del nga rrjeti i transmisionit për të shërbyer konsumatorët në Kosovë, siç është kalkuluar edhe në vitin 2008. ZRrE do të shqyrtojë

<sup>1</sup> Tarifat e SHST kalkulohen si të ardhurat totale nga tarifat SHST të alokuara për çdo nivel tensioni pjesëtuar me kërkesën në atë nivel tensioni.

dhe konfirmojë këto të dhëna para se të marrë vendim final për tarifat që do të aplikohen në vitin 2009

**Tabela 3: Kalkulimi I tarifave te propozuara të transmisionit**

		2008	2009
		Tarifa	Propozuar
Kostot totale të TNO	€000		8,739
Fuqia e angazhuar (400/220kV + 110kV)	MW		887
<b>Tarifa SHST 400/220kV</b>	<b>€/kW/vit</b>	3.618	<b>4.636</b>
Fuqia e angazhuar (110kV)	MW		848
Ngarkesa për njësi 110kV	€/kW/vit	4.260	5.458
<b>Tarifa SHST 110kV (përfshinë tarifën SHST të 400/220kV )</b>	<b>€/kW/vit</b>	<b>7.878</b>	<b>10.094</b>
Të ardhurat totale nga tarifa e SHST	€000		8,739
Kostot direkte te OS	€000		1,317
Kostot e humbjeve	€000		6,228
Kostot e shërbimeve ndihmëse	€000		1,591
Total kostot e OS	€000		9,136
Fuqia e angazhuar	GWh		9,714
<b>Tarifa e OS</b>	<b>€/MWh</b>	0.289	<b>0.941</b>
Total kostot e OT	€000		180
Fuqia e angazhuar	GWh		9,714
<b>Tarifa per OT</b>	<b>€/MWh</b>	0.013	<b>0.019</b>
Total të ardhurat e lejuara të KOSTT	€000		18,056